



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com
Date 11 Korrik 2017

KËRKESË PER TRANSPARENCE ME PUBLIKUN

Drejtuar: *znj.Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër*

E nderuar znj.Kryetare,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” që nga muaji Maj 2016 është angazhuar plotësisht në monitorimin e shoqërisë publike “Klubi Futbollit VLLAZNIA” sh.a proces i cili do të vazhdoj deri në fillimin e procedurave të privatizimit. Për këtë qëllim në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkuar bashkpunimin me Bashkinë Shkodër për të rritur shkallën e transparencës dhe të përgjegjshmërisë në këtë shoqëri!

Pas publikimit të raportit të IRSH mbi veprimtarinë e shoqërisë publike “Klubi Futbollit VLLAZNIA” sh.a konstatojmë një mungesë vullneti për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në administrimin e fondeve të shoqërisë duke qënë se rezulton se gjendja e shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a ka mbetur e njëjtë dhe e pandryshuar!

Një problem serioz mbetet mungesa e transparencës dhe e përgjegjshmërisë ndaj taksapaguesve shkodranë për mënyrën e administrimit financiarë të shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a, mënyrës së marrjes së vendimeve, mënyrës së ndarjes së përgjegjësisë dhe mungesës së një vendimi zyrtarë për fillimin e procedurave të privatizimit!

Ky fakt përforcohet nga analiza e bërë së fundi mbi aktivitetin e kësaj shoqërie e cila rezulton e dështuar në të gjitha drejtimet, si në objektivat financiarë, publikë dhe sportivë por sipas informacioneve të shpërndara në media të vetmit persona përgjegjës të identifikuar për këtë situatë rezultojnë të jenë lojtarët e larguar!

Mungesa e një plani masash për ndryshimin e kësaj gjendje si dhe fillimi i procedurave të privatizimit të cilat mbeten ende pa një vendim zyrtarë tregon qartazi për mungesën e vullnetit për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në këtë shoqëri!

Nga analiza e bërë nuk rezulton asnjë person apo strukturë drejtuese përgjegjëse për abuzimet financiare të konstatuara nga KLSH për shumën prej 35.652.852 Lekë për sigurime shoqërore e shëndetsore të papaguara për lojtarët e trenerët, referuar kontratave të lidhura!

Po ashtu nuk rezulton asnjë person apo strukturë përgjegjëse mbi abuzimet financiare të konstatuara nga KLSH për shumën prej 23.192.366 lekë e mbajtur sipas kontratave të lidhura me lojtarët dhe stafin sportiv si tatimi në burim e cila nuk është kontabilizuar dhe nuk është derdhur në Degën e Tatimeve Shkodër në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Nërkohë nga komunikimi me Ju informohemi se ekziston vetëm një marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të tatimeve Shkodër për një detyrim të pashlyer prej 7.663.325 leke dhe në total borxhi tatimorë kap vlerën prej 30.855.691 lekësh!

Nga ana tjetër llogaritë e shoqërisë si rezultat i neglizhencës së drejtuesve të kësaj shoqërie mbeten të bllokuara sipas një Vendimi Gjykate të formës së prerë dhe urdhërit për ekzekutim për një detyrim ndaj të tretëve për vleftën prej 76.600 Euro!

Ky borxh i mësipërm thellohet akoma më tepër nga disa vendime të kundraligjshme të Këshillit Mbikëqyrës për marrjen e huave në shuma të cilat kapin një vleftë totale prej 17.000.000 lekësh e 45.000 eurosh. Këto vendime nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak si i vetmi organ i cili ka kompetencën e miratimit të huamarrjes (shih fq 19 raporti i KLSH). Nga analiza e bërë së fundi nuk rezulton asnjë përgjegjësi si dhe nuk ka asnjë lloj transparence për fatin e shlyerjes së këtij borxhi!

Na. 06 prot
dt. 02.03.2016

Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.
Këshilli Mbikëqyrës

Adresa: Stadiumi "Loro Boriçi", Rr. Djepraxhiej, Nr. 2, Shkodër, Tel: +355 2224 2305, Fax: +355 22247514/43720

VENDIM
Nr. 7, datë 02.03.2016

Sot më datë 02.03.2016, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", e regjistruar si person juridik në QKR me NUIS: L170290015, me seli në Rr. Djepraxhiej, Nr.2 Shkodër, në mbështetje të nenit 158, 166, 167 të ligjit nr.9901, datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 22, 26, 29 të Statutit të kësaj shoqërie, pas shqyrtimit të situatës financiare të KF Vllaznia dhe propozimit të Administratorit,

VENDOSI

1. Të miratohet marrja e një borxhi prej 3000000 (tre milion) Lekë, me interes zero, nga fonde private, për të garantuar mbarevajtjen e punëve në KF Vllaznia sh.a.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratori i KF Vllaznia sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

Mark Laloshi
Admir Teli

Këshilli Mbikëqyrës
Shpëtim Quku
Benjamin Nako

Sytki Muçaj

26.08.2016

Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.
Këshilli Mbikëqyrës

Adresa: Stadiumi "Loro Boriçi", Rr. Djepraxhiej, Nr. 2, Shkodër, Tel: +355 2224 2305, Fax: +355 22247514/43720

VENDIM
Nr. 14, datë 26.08.2016

Sot më datë 26.08.2016, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", e regjistruar si person juridik në QKR me NUIS: L170290015, me seli në Rr. Djepraxhiej, Nr.2 Shkodër, në mbështetje të nenit 158, 166, 167 të ligjit nr.9901, datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 22, 26, 29 të Statutit të kësaj shoqërie, pas shqyrtimit të situatës financiare të KF Vllaznia dhe propozimit të Administratorit,

VENDOSI

1. Të miratohet marrja e një borxhi prej 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro, me interes zero, nga fonde private, për të garantuar mbarevajtjen e punëve në KF Vllaznia sh.a.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratori i KF Vllaznia sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

Mark Laloshi
Admir Teli

Këshilli Mbikëqyrës
Shpëtim Quku
Benjamin Nako

Sytki Muçaj

24.12.2016

Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.
Këshilli Mbikëqyrës

Adresa: Stadiumi "Loro Boriçi", Rr. Djepraxhiej, Nr. 2, Shkodër, Tel: +355 2224 2305, Fax: +355 22247514/43720

VENDIM
Nr. 16, datë 24.12.2016

Sot më datë 24.12.2016, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", e regjistruar si person juridik në QKR me NUIS: L170290015, me seli në Rr. Djepraxhiej, Nr.2 Shkodër, në mbështetje të nenit 158, 166, 167 të ligjit nr.9901, datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 22, 26, 29 të Statutit të kësaj shoqërie, pas shqyrtimit të situatës financiare të KF Vllaznia dhe propozimit të Administratorit,

VENDOSI

1. Të miratohet marrja e një borxhi prej 30000 (tridhjetë mijë) Euro, me interes zero, nga fonde private, për të garantuar mbarevajtjen e punëve në KF Vllaznia sh.a.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratori i KF Vllaznia sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

Mark Laloshi
Admir Teli

Këshilli Mbikëqyrës
Shpëtim Quku
Benjamin Nako

Sytki Muçaj

Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.
Këshilli Mbikëqyrës

Adresa: Stadiumi "Loro Boriçi", Rr. Djepraxhiej, Nr. 2, Shkodër, Tel: +355 2224 2305, Fax: +355 22247514/43720

VENDIM
Nr. 4, datë 08.01.2016

Sot më datë 08.01.2016, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", e regjistruar si person juridik në QKR me NUIS: L170290015, me seli në Rr. Djepraxhiej, Nr.2 Shkodër, në mbështetje të nenit 158, 166, 167 të ligjit nr.9901, datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 22, 26, 29 të Statutit të kësaj shoqërie, pas shqyrtimit të situatës financiare të KF Vllaznia,

VENDOSI

1. Të miratohet marrja e një borxhi prej 14000000 (katërmëdhjetë milion) Lekë, me interes zero, nga Federata Shqiptare e Futbollit, për të garantuar mbarevajtjen e punëve në KF Vllaznia sh.a.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratori i KF Vllaznia sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

Mark Laloshi
Admir Teli

Këshilli Mbikëqyrës
Shpëtim Quku
Benjamin Nako

Sytki Muçaj

Nga ana tjetër fillimi i këtij sezoni sportiv thellon mungesën e transparencës ku nuk tregohet asnjë lloj përkujdesje në menaxhimin në shërbim të objektivave të shoqërisë të talenteve shkodranë të cilët u aktivizuan me sukses vitin e shkuar por pagesat e tyre rezultojnë të jenë disa herë më të ulëta sesa të atyre që u cilësuan si të dështuar gjatë merkatos së fundit! Theksojm se transfertat e këtyre talenteve janë bërë në një mungesë të theksuar transparence duke mos u deklaruar shumat e përfituara nga “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a!

Vazhdimësia e aktivitetit të shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a me të njëjtën mënyrë drejtimi dhe menaxhimi përbën një rrezik real për përdorimin e buxhetit të taksapaguesve shkodranë dhe nevojës urgjente për t’iu përgjigjur në mënyrën e duhur prioriteteve të tyre!

Si rezultat i këtij menaxhimi të dobët, aktualisht, detyrimet ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve llogariten në një vleftë prej 300 milion lekësh, llogaritë e shoqërisë vazhdojnë të mbeten të bllokuara si rezultat i detyrimeve ndaj të tretëve!

Prandaj është e domosdoshme që të tërhiqeni nga kjo “aventurë e rrezikshme” e cila nuk ju garanton përmbushjen e objektivave publikë në menaxhimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër sipas prioriteteve të qytetarëve shkodranë, nuk ju garanton respektimin e marëdhënieve financiare me palët e treta apo për lojtarët që do të kontraktoni për arritjen e objektivave sportivë!

Mungesa e reagimit ndaj kërkesës së vazhdueshme të mbarë qytetarëve shkodranë për fillimin e menjëhershëm të procedurave të privatizimit sjell si domosdoshmëri vendosmërinë tonë për të bërë transparente aktivitetin e shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a duke sensibilizuar për këtë qëllim jo vetëm qytetarët shkodranë por edhe të gjithë mekanizmin shtetërorë ligjzbatues si dhe trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri

Prandaj për këtë arsye vendosëm t’iu drejtohem me anë të kësaj kërkesë publike për përmbushjen e qëllimit tonë të përbashkët, rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj taksapaguesve shkodranë nga paratë e të cilëve financohet “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a

E nderuar znj.Kryetare,

Nga deklarata e Juaj e fundit dhënë në media në datën 30 Qershorë 2017, (shih linkun e intervistës <https://www.youtube.com/watch?v=a1EvcvLawoA>) keni informuar se tashmë ka filluar procesi i vlerësimit të aseteve të shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a. Nga vëzhgimi që i kemi bërë aplikacionit të Bashkisë për Transparencën e Buxhetit rezulton se fondi prej 1 milion lekësh akoma nuk është prokuruar dhe shpenzuar!





The screenshot shows a web browser displaying the 'Bashkia Shkodër - Transparenca e Buxhetit' website. A modal window titled 'Programi Buxhetor: Rinia dhe Sportet' is open, showing a table with budget details. The table has three columns: 'Emërtimi', 'Vlera e Planifikuar', and 'Vlera e Realizuar'. The data is as follows:

Emërtimi	Vlera e Planifikuar	Vlera e Realizuar
1. Vlerësim i aseteve dhe përgatitja e dokumentacionit për shitjen me ankand të aksioneve të Bashkisë Shkodër në KUJBIT "FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me NIPIN L17029001S	1,000,000 Leke	0 Leke <i>Me shumë</i>
2. Ekipi i basketbollit i te rriturve për meshkuj	3,735,000 Leke	0 Leke <i>Me shumë</i>
3. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura	1,600,000 Leke	0 Leke <i>Me shumë</i>
4. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	480,000 Leke	0 Leke <i>Me shumë</i>
5. Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur	3,300,000 Leke	774,000 Leke <i>Me shumë</i>

Ju lutem znj.Kryetare a mund të na informoni se kujt duhet ti besojnë qytetarët në këtë rast: Aplikacionit mbi transparencën e buxhetit ku nuk pasqyrohet asnjë e dhënë mbi fillimin e procedurës së vlerësimit të aseteve apo Deklaratës tuaj të dhënë në media se procesi mbi vlerësimin e aseteve tashmë ka filluar???

Në konferencën për shtyp të drejtuesve të Vllaznisë me datë 13 Prill 2017 u deklarua se ekziston një marrëveshje për pagesën me këste të një borxhi tatimorë në një vleftë prej 220 milion lekësh (Shih tekstin e deklaratës së drejtuesve të shoqërisë <http://vllaznia.al/index.php/component/content/article/3-newsflash/1134-2017-04-13-16-36-28>). Nga komunikimet me Bashkinë nëpërmjet shkresës nr.6313.prot datë 03.05.2017 jemi informuar se Shoqëria “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” Sh.a ka vetëm një marrëveshje me Drejtorinë e Tatimeve Shkodër nr.1261/I prot datë 29.01.2016 për pagesë me këste në lidhje me një borxh tatimorë të papaguar prej vetëm 7.663,325 dhe se marrëveshje të tjera nuk ka!



A nuk përbën ky fakt një dizinformim publik ndaj qytetarëve shkodranë në lidhje me detyrimin tatimorë të shoqërisë??? A duhet të mbaj dikush përgjegjësi për këtë deklaram publik të rremë??? Përse nuk e bëni publik shlyerjen e detyrimit prej 23.192.366 lekë të mbajtur sipas kontratave të lidhura me lojtarët dhe stafin sportiv si tatimi në burim detyrimi sipas rekomandimeve qe ju ka lënë KLSH???

Nëpërmjet shkresës nr.65.prot datë 17.03.2017 të dërguar nga Administratori i shoqërisë njoftohemi se anëtarët dhe Kryetari i Këshillit Mbikqyrës paguhen me “zero lekë” ndërkohë që informohemi se nëpërmjet një Vendimi në konflikt të hapur interesi të Këshillit Mbikqyrës, nr.6 datë 07.01.2017, është miratuar dhe ka marrë fuqi ky vendim, pa u miratuar mëparë në Asamble, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 160 të ligjit 9901,

datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Pra pagesa e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës rezulton të jetë 10% të pagës bruto të Administratorit ndërsa pagesa e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të jetë 15% e pagës bruto të administratorit dhe jo siç jemi informuar "zero lekë"!



VENDIM

Nr. 6, datë 07.01.2017

Sot më datë 07.01.2017, Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", e regjistruar si person juridik në QKR me NUIS: L170290015, me seli në Rr. Djepaxhiej, Nr.2 Shkodër, në mbështetje të nenit 158, 166, 167 të ligjit nr.9901, datë 14.08.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe nenit 22, 26, 29 të Statutit të kësaj shoqërie, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e Administratorit,

VENDOSI

1. Të miratohet pagesa e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës sipas ligjeve në fuqi, në vlerën 10% të pagës bruto të Administratorit për anëtarët e thjeshtë dhe në vlerën 15% për kryetarin e këshillit.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratori i KF Vllaznia sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

Këshilli Mbikqyrës

Mark Laloshi
Shpëtim Çuku
Sytqi Muçaj

Admir Teli
Benjamin Nako

KLUBI I FUTBOLLIT "VLLAZNIA" sh.a.	FOOTBALL CLUB "VLLAZNIA" j.s.c.	Stadiumi "Loro Boriçi" Rruga "Djepaxhiej", Nr.2, Shkodër, ALBANIA Tel: +355 2224 2305 Mob. +355692099799 Mail: info@vllaznia.al Web: www.vllaznia.al	
65 prot Lenda : Dërgim informacioni mbi strukturen e pagave/honorareve përkatëse për punonjësit e shoqërisë KF "VLLAZNIA" sh.a		Shkodër, / 03.2017	
Drejtuar : I.R.SH -Shkodër Adresa : L. Qemal Stafa, Rr. Daut Boriçi, Nr. 874			
Për dijeni : Bashkia Shkodër Kryetares Voltana Ademi			
Në mbështetje të pika 2 e nenit 19 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.02.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenit 3 dhe 7 pika d të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Neni 7, pika 2, germa e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, nenin 5 dhe 6 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" si dhe në përgjigje të kërkesës për informim të bërë nga ana e shoqatës I.R.SH – Shkodër drejtuar Bashkisë Shkodër dhe e protokolluar me Nr.3120 prot datë 07.03.2017 në protokollin e Bashkisë, kërkesë kjo e ardhur pranë K.F."Vllaznia" sh.a me datë 07.03.2017, po ju dërgojmë informacionin e kërkuar në lidhje me:			
Strukturen e pagave/honorareve përkatëse mujore që paguhet për:			
a.			
Nr.	Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës	Emër Mbiemër	Page mujore
1.	Kryetar	Shpëtim Çuku	zero lekë
2.	Anëtar	Mark Laloshi	zero lekë
3.	Anëtar	Ben Nako	zero lekë
4.	Anëtar	Admir Teli	zero lekë
5.	Anëtar	Sytqi Muçaj	zero lekë
b.			
Nr.	Stafi Drejtues	Pagë mujore bruto	
1.	Administrator	80.000 lekë (tetëdhjetëmijë)	
2.	Drejtori Sportiv	70.000 lekë (shtatëdhjetëmijë)	
3.	Zedhënës	40.000 lekë (dyzetmijë)	
4.	Financier	40.000 lekë (dyzetmijë)	
5.	Jurist	35.000 lekë (tridhjetë e pesëmijë mijë)	

LEMBLIMI I DOKUMENTIT SHKODËRA, KËRKËSA
NR. 3644 DATË 17.03.2017
BESHKËSHI
LETRA

PROKURIA E TITULLARIT

A nuk përbën ky fakt një mungesë të theksuar transparence dhe përgjegjshmërie në këtë shoqëri???

Prandaj përsa mësipër me anë të kësaj kërkesë për transparencë me publikun Ju kërkojm që në bazë të nenit 3, të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit" të bëni transparente dhe të na informoni në lidhje me:

- 1) **Masat administrative që do ndërmerrni ndaj personave përgjegjës në lidhje me mungesën e përgjegjshmërisë dhe transparencës ndaj publikut përsa referuar mësipër me fakte dhe prova shkresore!**
- 2) **Ju kërkojm të bëni transparente pagesën e detyrimit të pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në shumën prej 23.192.366 lekë për tatimin nga të ardhurat nga punësimi i mbajtur në masën prej 15% për lojtarët e ekipit të parë si pjesë e rekomandimit të lënë nga KLSH për veprim të menjëhershëm! (shih: fq 75 të raportit të KLSH). Ju kërkojm të na dërgoni kopje të pagesave të kryera për ekzekutimin e këtij detyrimi!**
- 3) **Ju kërkojm të bëni transparente dhe të na informoni mbi shlyerjen e huasë të marrë në mënyrë të kundraligjshme nga Këshilli Mbikqyrës për shumat prej 17.000.000**

lekësh e 45.000 eurosh si dhe masat e ndërmarra ndaj këtij veprimi në kundërshtim të hapur me ligjin!

- 4) Ju kërkojm të bëni transparente dhe të informoni mbi shumën financiare te perfituar nga “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. nga transferimet e talentave shkodranë!*
- 5) Ju kërkojm të bëni transparente dhe të na informoni mbi procedurën e prokurimit të fondit prej 1 milion lek për vlerësimin e asetëve të shoqërisë “Klubi i Futbollit VLLAZNIA” sh.a, (Ju lutem na dërgoni kopje të gjithë dokumentacionit që i përket procedurës së prokurimit)*
- 6) Në zbatim të germës dh) pika 1 të nenit 7 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” ju kërkojm të publikoni në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër raportin e KLSH Mars 2017 në shoqërinë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a.*

Mbetemi në pritje të informacionit të kërkuar, brenda afatit të përcaktuar ligjorë!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH